



PLATFORMA EXPORT ALBANIA

Platforma EXPORT ALBANIA është instrumenti i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit German Agency for International Cooperation (GIZ), gjithmonë pranë bizneseve me shërbime që bëjnë diferencën. E ndërtuar për të shërbyer si një mekanizëm promotor shumë-dimensional, EXPORT ALBANIA i siguron eksportuesve shqiptarë rritjen e njohurive mbi përfitimet e ekspozimit ndërkombëtar, zhvillimin e aftësive për përthithjen e shpejtë të kuadrit ligjor dhe krijimin e lidhjeve të nevojshme për të qënë konkurrues në tregjet ndërkombëtare.

Kjo platformë ofron shërbime dhe burime të ndryshme për të lehtësuar eksportin, duke përfshirë

- Trajtime specializuese për standardet e BE-së dhe analiza të tregut.
- Lidhje direkte me blerës të huaj dhe pjesëmarrje në ekspozita globale.
- Mbështetje financiare përmes informacioneve për subvencione dhe gara.
- Network me biznese dhe partnerë ndërkombëtarë si GIZ dhe AIDA.

Export Albania si një dritare unike inovative që shndërron produktet "Made in Albania" në histori suksesi ndërkombëtarë u jep bizneseve shqiptare mjetet dhe dukshmërinë që u nevojiten për të hyrë në tregjet e huaja, duke i lidhur direkt me kërkesën globale.

Shumë biznese të vogla përballen me sfida për të hyrë në tregjet ndërkombëtare. Export Albania ju ofron mjete dhe mbështetje për të kapërcyer çdo pengesë dhe për të rritur biznesin tuaj globalisht. Mjeti i Vetë-Vlerësimit mudëson një shërbim praktik për përdoruesit, i hartuar për të ndihmuar bizneset të vlerësojnë gatishmërinë e tyre për eksport dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare.

Merrni mbështetjen e duhur për të zgjeruar biznesin tuaj, eksploroni shërbimet tona në www.exportalbania.al! Gjithashtu ju mund të krijoni llogarinë tuaj për të patur akses të shpejtë dhe të gjerë për prezantimin dhe promovimin e biznesit tuaj.

Bashkohuni me platformën dhe bëhuni pjesë e tregut global!



AIDA PJESË E FORUMIT NDËRKOMBËTAR FII (FUTURE INVESTMENT INITIATIVE)

Për herë të parë, Forumi Ndërkombëtar FII (Future Investment Initiative) u zhvillua në Tiranë, duke e kthyer Shqipërinë në epiqendrën e diskutimeve për inovacion dhe investime globale.

Forum i mbledhi liderë politikë, drejtues të korporatave dhe investitorë për të diskutuar mbi teknologjinë, energjinë e gjelbër, ekonominë digjitale dhe mundësitë e reja të investimeve.

Mesazhi kryesor: "Investoni në një Europë të Ndërlidhur!" – një thirrje për të forcuar lidhjet ekonomike dhe për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme.

Figura të njohura në botën e biznesit dhe ekonomisë, treguan sesi Shqipëria është një destinacion premtues për investitorët.



TRYEZA E RRUMBULLAKËT -BASHKËBISEDIM PËR FORCIMIN E SEKTORIT ICT/BPO.

Në një format bashkëkohor të tryezës së rrumbullakët, pranë zyrave të AIDA-S u zhvillua një dialog strategjik midis përfaqësuesish të institucioneve përkatëse dhe bizneseve kryesuese të sektorit ICT/BPO që operojnë në Shqipëri.

Qëllimi kryesor ishte identifikimi i hapave konkretë për përmirësimin e klimës së investimeve dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të këtij sektori.

Kjo tryezë e rrumbullakët bëri bashkë Zv. Ministren e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Znj. Blerta Rama, Drejtoreshën e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve Znj. Laura Saro, përfaqësues nga Shoqata e Liderëve të Shërbimeve të Biznesit (ABSL Albania), përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), përfaqësues nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe një sërë përfaqësuesish nga kompanitë më të mëdha që operojnë në vend.

Gjatë tryezës u theksua rëndësia e këtij sektori, sidomos për numrat e lartë të të punësuarve nga ana e kompanive të huaja dhe shqiptare që operojnë në vend, si dhe potenciali që Shqipëria ofron për tërheqjen e investimeve të mëtejshme në këtë sektor.

Kompanitë prezente shprehën një interes të shtuar për programet e nxitjes së punësimit dhe përfitimt nga këto programe, kjo edhe si rrjedhojë e problematikave të lidhura me gjetjen e forcës punëtore të përshtatshme për këtë sektor.

AIDA do të ndjekë në vijim adresimin e problematikave dhe organizimin e takimeve me institucionet respektive për adresimin e këtyre çështjeve.



FUSHATA AFTER CARE -PËRKUJDESJE NDAJ INVESTITORIT

Gjatë muajit Maj AIDA në bashkëpunim me ABSL Albania realizoi vizita Aftercare pranë kompanive të sektorit ICT/BPO. Qëllimi kryesor i takimeve ishte të identifikojë nevojat konkrete të kompanive të mëdha dhe të nxisë bashkëpunimin për përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit në këtë sektor strategjik.

Kompanitë që u vizituan ishin:

- **TOK Digital,**
- **Novus Albania,**
- **Hermex,**
- **Assist Digital,**
- **Concentrix Albania,**
- **Communication Progress,**
- **Digit Sapiens,**
- **Fast Payroll dhe**
- **First.**

Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë takimeve ishin:

-Diskutime mbi mundësitë konkrete për bashkëpunim dhe përforcimin e rolit të institucioneve në zhvillimin e sektorit ICT/BPO.

-Diskutime mbi eksperiencat e kompanive në tregun shqiptar, si dhe nevojat për mbështetje institucionale në rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm.

-Sfidat dhe nevojat aktuale të kompanive, si dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm me institucionet dhe aktorët e tregut.

-Synimet për zgjerimin e investimeve, kryesisht në zhvillimin e produkteve të reja dhe integrimin e inteligjencës artificiale, dhe teknologjive të tjera të avancuara.

Këto kompani të mëdha prazantuan projekte të realizuara si brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunime të qëndrueshme me partnerë në Europë dhe SHBA, si dhe idetë inovative për përmirësimin e klimës së biznesit në këtë sektor me potencial të lartë zhvillimi.

Kjo fushatë shërbeu për të njohur më në detaje avantazhet, sfidat dhe ecurinë e kompanive në tregun ICT/BPO.



AIDA MIRËPRET PËRFAQËSUES TË DELOITTE GERMANY

Në kuadër të mbështetjes për nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri, AIDA mirëpriti përfaqësues të Deloitte Germany: znj. Ana Gombovic & z. Hans-Christian Busch, konsulentë strategjik në fushën e Real Estate & Transformation.

Qëllimi i vizitës lidhej me asistimin e një klienti potencial gjerman, i cili ka shprehur interes për të investuar në sektorin e Qendrave të Shërbimeve të Përbashkëta (SSC) në Shqipëri.

Në rolin e saj si një "one-stop-shop" për investorët, AIDA organizoi dhe ndërmjetësoi një sërë takimesh me bashkëpunëtorë të mundshëm që mund të kontribuojnë në realizimin e këtij projekti.

Të pranishëm në takim ishin:

- Znj. Florenca Haxhi, CEO e Durana Techno Park, e cila prezantoi në detaje projektin që pritet të zbatohet, duke përfshirë incentivat fiskale, përfitimet financiare dhe lehtësitë administrative që u ofrohen kompanive të teknologjisë së informacionit dhe nomadëve digjitalë.

- Znj. Elona Poga, përfaqësuese e Shoqatës ABSL, e cila theksoi rëndësinë e programeve për edukimin dhe trajnimin e talenteve të rinj në fushën e shërbimeve të biznesit dhe teknologjisë.

- Rekrutues të tregut vendas, të cilët ndanë ekspertizën e tyre mbi veçoritë e tregut të punës në Shqipëri.

- Znj. Elona Ymeri, përfaqësuese e kompanisë Assist Digital, e cila ndau eksperiencën e kësaj kompanie në sektorin konsulentë dhe teknologji dixhitale në Shqipëri që prej vitit 2016.

Tryeza e rrumbullakët e takimet e zhvilluara shërbyen për të adresuar shumë nga pyetjet dhe interesat e përfaqësuesve të Deloitte, jo vetëm në lidhje me sektorin e IT-së, por edhe me tregun e punës, disponueshmërinë e fuqisë punëtore, kërkesën në rritje dhe perspektivën e përgjithshme që ofron Shqipëria në fushën e ICT/BPO dhe SSC.



Shqipëria pjesëmarrëse në eventin CxOutsourcers 2025

Shqipëria u prezantua me sukses si një destinacion strategjik në rritje për outsourcing, investime të huaja direkte (FDI) dhe shërbime dixhitale gjatë eventit CxOutsourcers 2025 të mbajtur në Mynih. Eventi mbledhi udhëheqës të lartë nga sektorët globalë të përvojës së klientit (CX), outsourcing-ut të proceseve të biznesit (BPO) dhe inovacionit dixhital, duke ofruar një platformë me ndikim të lartë për ta pozicionuar Shqipërinë në hartën ndërkombëtare të investimeve.

Përmes diskutimeve të fokusuara, një prezantimi të dedikuar, pjesëmarrjes në tryezë të rrumbullakët dhe rrjetëzimit të synuar, AIDA, si pjesë e delegacionit shqiptar u fokusua në evidentimin e pikave të forta të Shqipërisë, kryesisht sa i takon talentit në fushën e teknologjisë, aksesit nearshore, mbështetjes së investitorëve dhe infrastrukturës në zhvillim.



AIDA mori pjesë në eventin Albania & Türkiye B2B Meetings

Një ditë e mbushur me energji pozitive, ide të reja dhe bashkëpunime të mundshme në Albania & Türkiye B2B Meetings, mbajtur më 6 Maj në Maritim Plaza Hotel, Tiranë.

Ky event ofroi një platformë të shkëlqyer për networking, shkëmbim përvojash dhe hapje rrugësh për partneritete të reja ndërmjet bizneseve shqiptare dhe turke.

Ky event ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të forcuar urat e bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve tona dhe për të prezantuar Keller Williams Albania si një One-Stop-Shop për investitorët e huaj që kërkojnë të bëjnë hapa të sigurt në tregun imobiliar shqiptar.

Ky event ishte një mundësi e jashtëzakonshme për të forcuar urat e bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve tona dhe për të prezantuar Keller Williams Albania si një One-Stop-Shop për investitorët e huaj që kërkojnë të bëjnë hapa të sigurt në tregun imobiliar shqiptar.

Me një portofol të gjerë pronash, ekspertizë lokale dhe një rrjet ndërkombëtar që i mbështet në çdo hap, Keller Williams Albania është zgjidhja ideale për investitorët që kërkojnë siguri, transparencë dhe potencial të lartë kthimi në Shqipëri.



AIDA -Takim me përfaqësuesit e kompanisë DP World

Përfaqësuesit e kompanisë DP World, një nga operatorët më të mëdhenj në botë në fushën e porteve dhe një aktor kyç në infrastrukturën globale tregtare, u pritën në një takim zyrtar nga stafi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

E themeluar për herë të parë në Dubai në vitin 1972, DP World ka zgjeruar prezencën e saj në më shumë se 75 vende të globit. Aktiviteti i kompanisë fokusohet në ndërtimin dhe menaxhimin e infrastrukturës logjistike përmes një rrjeti të integruar që përfshin Porte dhe Terminale, Shërbime Detare, Kontrata Logjistike si dhe Zona të Lira Ekonomike, të cilat ofrojnë lehtësira fiskale dhe doganore për investitorët.

Takimi u vlerësua si shumë produktiv, duke hedhur bazat për një bashkëpunim të mundshëm në të ardhmen dhe duke theksuar potencialin e Shqipërisë për të ofruar një zinxhir të plotë logjistik të integruar. Kjo iniciativë përbën një hap strategjik në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe tërheqjes së investimeve të huaja në vendin tonë.



AIDA mirëpriti në një takim frymëzues studentët e ekonomisë

Studentët, që u angazhuan si vullnetarë në eventet Match-Maker Albania dhe ZAN'ART, u pritën në një takim ndryshe në AIDA.

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA dhe znj. Blerta Rama, Zëvendës Ministre e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përgëzuan pjesëmarrësit, ndanë me ta rrugëtimin e tyre të karrierës dhe plot këshilla motivuese. Kjo iniciativë me studentët, për përafrimin e tyre me praktikën ishte vetëm hapi i parë i ndërmarrë.

Në përfundim, studentët morën certifikatat e pjesëmarrjes, për të dëshmuar përvojën e tyre unike të fituar nga këto angazhime.




Shqipëria në Fokusin e Hollywood-it: Një arritje e madhe për Industrinë e Filmit dhe Ekonominë e Vendit

Shqipëria ka mirëpritur përfaqësues të një profili të lartë nga industria më prestigjioze e filmit në botë, si Warner Brothers, NBC, Universal, Paramount, Disney, e të tjerë, duke konfirmuar interesin e qartë të Hollywood-it për të eksploruar Shqipërinë si një destinacion të ri për produksione filmike dhe televizive në Europë.

Kjo vizitë vjen në kuadër të një strategjie globale të industrisë amerikane të filmit për të zgjeruar investimet jashtë Shteteve të Bashkuara, me synim gjetjen e vendeve me potencial të lartë artistik, kreativ dhe logjistik. Shqipëria është përzgjedhur jo vetëm për natyrën mahnitëse që ofron për xhirime, por edhe për pasurinë e talenteve të reja, me pasionin për t'u përfshirë në industrinë globale të filmit. AIDA e ka mbështetur këtë iniciativë që prej fillimit, nëpërmjet angazhimit të saj të plotë, si në ndërlidhjen me institucionet përgjegjëse, gjetjen e partnerëve lokalë dhe asistimin e nevojshëm, për të konkretizuar dhe zhvilluar një projekt të tillë.

Në takim, znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA, siguroi se do ndërmerren hapat e duhur në kuadër të infrastrukturës ligjore apo lehtësive që industria e filmit do ketë nevojë, duke marrë në konsideratë ndikimin që sjell kjo industri, e cila deri më tani nuk ka qenë ndër sektorët prioritarë të Shqipërisë. Gjithashtu, Philip Gilpin Jr., CEO i "Catalyst Story Institute", prezantoi "Tirana Training Center" – një qendër moderne në ambientet e Kinostudios që do të ofrojë mbi 180 programe të ndryshme edukimi, të dedikuara për të përgatitur profesionistë të çdo moshe, në të gjitha hallkat e procesit të produksionit – nga skenari dhe regjia, deri te efektet speciale dhe post-produksioni.

Dikur e panjohur në hartën filmike botërore, Shqipëria po kthehet sot, në një pikë referimi për produksionet e mëdha ndërkombëtare – një mundësi e artë që shënon një gur themeli për zhvillimin e industrisë së filmit, televizionit dhe ekonomisë në tërësi.



AIDA në kuadër të projektit “Balkonnnect Festival”

Sesioni tematik V –Ndërmarrjet Sociale: Gratë Sipërmarrëse dhe Ekosistemi Ndërkulturor.

Një diskutim frymëzues në ndërthurjen e gjinisë, sipërmarrjes dhe ndikimit social.

Ky sesion solli në qendër të vëmendjes rolin transformues të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë dhe modeleve gjithëpërfshirëse të biznesit në/ndërtimin e ekonomive më të qëndrueshme, të larmishme dhe të gatshme për të ardhmen, si në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe përtej tij. Qasja në financim dhe mentorim, ndërlidhja ndërkulturore dhe fuqizimi i komuniteteve lokale ishin në fokus — një dëshmi e fuqishme se gratë sipërmarrëse po e udhëheqin të ardhmen. Me qëllim të qartë, të udhëhequra nga ndikimi dhe të bazuara në barazi.

Një kujtesë se ekosistemet gjithëpërfshirëse nuk janë vetëm të nevojshme — janë të pandalshme.



AIDA në kuadër të projektit të UNESCO-S “CC4WBS”

Në kuadër të projektit të CC4WBS (Culture and Creativity for the Western Balkans), AIDA mori pjesë në eventin Innovation Hub që u zhvillua tek Piramida. Në çdo udhëtim krijues vjen një moment kur idetë kanë nevojë për më shumë se pasion — kanë nevojë për mbështetje për të marrë jetë.

Në Innovation Hub në Piramidë, ofruam pikërisht këtë: mbështetje të dedikuar për dhjetëra aktorë të industrive kulturore dhe kreative (CCI).

Punëtorja Culture Connects mbledhi institucione kyçe dhe partnerë, të cilët ndanë njohuri, përvojë dhe frymëzim:

Ndërkohë, Urban Research Institute me programin “Boost Balkans”, Muzeu i Gruas dhe Albanian Night ndanë histori suksesi që frymëzuan të pranishmit.

Eventi u organizua në kuadër të programit “Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor (CC4WBs)” të financuar nga BE dhe zbatuar nga Western Balkans Fund me mbështetjen e @aics_tirana.



AIDA në kuadër të programit “ProSEED”

Gjatë muajit Maj u zhvillua zyrtarisht Mbyllja & Demo Day e programit **Ecosystem Builders Albania**.

Nga Marsi 2024 deri në Maj 2025, kjo nismë e financuar nga BMZ, e zbatuar nga GIZ Albania në kuadër të programit ProSEED 2.0 dhe në partneritet me enpact punoi me 6 BSO dhe Dhoma Tregtie për të bashkëkrijuar shërbime të personalizuar për NVM-të shqiptare.

AIDA prezantoi me krenari:

- ♦ Një mjet vetëvlerësimi për gatishmërinë për eksport në sektorin e këpucëve dhe lëkurës
- ♦ Udhëzues praktik për EUDR dhe Rrugën drejt certifikimit

Sipërmarrësit që pilotuan këto shërbime ndanë përvojën e tyre drejtpërdrejt në skenë—provë që mjetet e duhura bëjnë diferencën.



AIDA - Takim me International Finance Corporation (IFC)

AIDA zhvilloi një takim me përfaqësuesit e IFC për të diskutuar mbi zhvillimin e Parqeve Eko-Industriale në Shqipëri.

Ky model inovativ vendos vendin tonë në qendër të tranzicionit të gjelbër dhe nxit investime të reja në teknologji të pastër, energji të rinovueshme dhe industri të avancuara.

Bashkëpunimi përfaqëson një hap strategjik për modernizimin industrial dhe përmirësimin e klimës së investimeve, në përputhje me misionin për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.



AIDA – Takim me përfaqësues të kompanive turke

Përfaqësues të lartë të kompanive turke Turqualis dhe Yörük Holding, të njohura për aktivitetin e tyre në sektorin e ndërtimit dhe infrastrukturës civile, u pritën në një takim zyrtar nga stafi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Gjatë takimit, përfaqësuesit e kompanive shprehën interesin e tyre për të investuar në Shqipëri, duke vlerësuar pozicionin strategjik të vendit, mundësitë që vendi ofron në sektorin e turizmit dhe infrastrukturës, si dhe klimën gjithnjë e më të favorshme për investitorët e huaj.

AIDA prezantoi projektet në zhvillim dhe mundësitë konkrete për investime afatgjata dhe të qëndrueshme, duke theksuar angazhimin institucional për të ofruar mbështetje të plotë përgjatë gjithë ciklit investues, si dhe lehtësitë dhe incentivat që Shqipëria ofron për investitorët e huaj.



AIDA në bashkëpunim me SIPPO, realizoi takimin e parë me 7 kompanitë pjesëmarrëse në panairin “RIGA FOOD”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), sëbashku me partnerin “SIPPO Albania” dhe me 7 kompani shqiptare, do jetë pjesëmarrëse për herë të parë, në panairin “RIGA FOOD” që do të zhvillohet në datat 04-06 Shtator 2025, në Letoni.

Në kuadër të përgatitjes për pjesëmarrjen në këtë panair, ditën e djeshme, AIDA në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO), realizoi takimin e parë me kompanitë shqiptare të sektorit Vajit të Ullirit, Çajrave, Mjaltit, Frutave dhe Ekstraktit të frutave që do të jenë pjesëmarrëse në panair. SIPPO do të ofrojë asistencën tyre financiare dhe teknike për këto kompani, duke i asistuar për një pjesëmarrje sa më efektive në panair. Gjatë takimit, u realizua koordinimi dhe këshillimi i kompanive mbi fazat e organizimit dhe realizimit të pjesëmarrjes në panair.

Ky takim, ishte hapi i parë i punës përgatitore që do ndiqet në vijim, me qëllim përfaqësimin sa më dinjitoz të Shqipërisë në këtë panair të rëndësishëm.



AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: “WE Rise”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: WE Rise

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/we-rise>



AIDA ju fton të merrni pjesë në edicionin e ardhshëm të SIRHA/+ BUDAPEST 2026

AIDA ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në edicionin e ardhshëm të SIRHA/+ BUDAPEST 2026, një nga panairët më me emër të sektorit Ushqim & HoReCa në Evropën Qendrore, që do të zhvillohet më 3-5 mars 2026 në Budapest, Hungari.

Ky aktivitet përfaqëson një mundësi të shkëlqyer për kompanitë shqiptare që të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre, të krijojnë kontakte me partnerë rajonalë dhe të eksplorojnë mundësi të reja biznesi në tregjet e Hungarisë dhe më gjerë.

Edicioni i vitit 2024 shënoi një sukses të jashtëzakonshëm, me një numër rekord vizitorësh dhe përfaqësuesish të industrisë, duke ofruar risi, rrjetëzim të nivelit të lartë dhe programe profesionale tërheqëse.

Ju ftojmë të merrni pjesë në këtë panair ndërkombëtar, me qëllim promovimin e eksportit dhe forcimin e pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Për më shumë informacione dhe regjistrim, ju lutemi kontaktoni:

✉ sirha-budapest@hungexpo.hu

🌐 www.hungexpo.hu

☎ +36 1 263-6000

SIRHA/+ BUDAPEST

3-5
MARCH
2026

HUNGEXPO
BUDAPEST

